



RAPORT I IMPLEMENTIMIT TE MAMOGRAFISË MOBILE
PROJEKTI “MA-MO”



Komuna: Ranillug

Nga: Dr.Ardian Biçaku^{1,2}

¹SHSKUK/QKUK Klinika e Radiologjis, Prishtinë

²Koordinator i Mamografisë Mobile në SHSKUK

Periudha e raportimit: 22 Qershor – 29 Qershor, 2015

Korrik, 2015

Mamografia Mobile në Komunën e Ranillugut


Mamografi Mobil ka qëndruar në Komunën e Ranillugë nga data 22.06.2015 deri më datën 29.06.2015. Janë ekzaminuar gjithësej 93 femra. Komuna e Ranillugut banohet kryesisht nga komuniteti Serb, dhe nuk posedon shërbim mamografik.

Organizimi, bashkëpunimi dhe pritja nga stafin lokal ka kaluar konform planit të implemetimit të Mamografit Mobil. Përgjigja ndaj thirrjes për ekzaminim i ka tejkaluar pritjet tona nga banorët e kësaj komune. Bashkëpunimi ishte i mrekullueshëm.

Gjatë këtyre 6 ditë pune në Komunën e Ranillugut janë ekzaminuar 93 femra, mesatarisht nga 15.5 femra në ditë. Me këtë numër kemi kaluar pritjet tona për 15 ekzaminime në ditë. Ky numër paraqet 10% e nevojave të Kosovës për screening mamografi.

Leximi i ekzaminimeve mamografike në Komunën e Ranillugut është bërë nga radiologët Klinikës së Radiologjisë të QKUK-së.

Grafiku 1. Numri i ekzaminimeve gjatë ditëve të qëndrimit në Komunën e Novobërdës.



1. Të dhënat nga ekzaminimet mammografike në Komunën e Novobërdës

Në Komunën e Ranillugut janë ekzaminuar gjithësej 93 femra. Përgjigja e femrave për ekzaminim mamografik, ashtu si në komunat paraprake, ishte e kënaqshme. Përgjigja e komunitetit serbe dhe mikëpritja ishte në nivel të lartë miqësorë dhe kolegial.

Të ekzaminuarat janë kryesisht nga komuniteti serb.



Tabela 1. Moshë e femrave të ekzaminuar në Komuna e Ranillugut.

Minimal age	30
Maximal age	69
Median age	53.34

Tabela 2. Stratifikimi i moshës dhe numri i pacientëve në grupmosha.

	<40	40-49	50-69	>70	Totali
Nr. I femrave	2	25	66	0	93
%	2.2	26.9	71.0	0.0	

Rreth 77.4% e femrave kanë bërë për herë të parë mammografinë (MMG 1), 21% MMG për herë të dytë. Në bazë të të dhënave në 21 femrat të cilat janë ekzaminuar për herë të dytë me MMG (MMG2); MMG e fundit silltet nga 1 vit deri në 30 vite me një mesatare prej 4.5 vjet dallim kohorë nga mamografia e parë. Shumica e mamografive të para janë realizuar jashtë Kosovës (Vranjë, Bujanovc, Beograd, Nish, dhe 1 në Prishtinë para 18 viteve)

Tabela.3. Mammografi (MMG) për herë të parë, dytë dhe tretë.

MMG during life	N	%
MMG 1	72	77.4
MMG 2	21	22.6
MMG 3	0	0.0
MMG 4	0	0.0
Total	93	100.0

Vlerësimi i gjetjeve nga ekzaminimet mammografike është bërë në bazë të BIRADS leksikonit.
 BIRADS 0 – kërkohet ekzaminim shtesë (ultrazë apo projeksion shtesë mammografik)
 BIRADS 1 – pa ndryshime evidente
 BIRADS 2 – gjetje beninje
 BIRADS 3 – gjetje probabilisht beninje
 BIRADS 4 – (A,B,C) - gjetje të dyshimta,
 BIRADS 5 – gjetje shumë të dyshimta për malinjitet,
 BIRADS 6 – diagnozë e mëhershme e verifikuar me biopsi për malinjitet.

Rekomandimet për ekzaminime shtesë (ultrazë apo projeksion shtesë mammografik) BIRADS 0 kanë rezultuar 20.4% (N=19) dhe janë ordinuar në SR te Gjilanit dhe QKUK-së.

Mungojnë informatat për evaluimet e mëtutjeshme për kategoritë BIRADS 0 -- kërkohet koordinim me spitalin regjional te Gjilanit dhe QKUK/SHSKUK për ekzaminimet shtesë.

Vlerësimet BIRADS 1 dhe 2 janë 72 (77.4%) raste, dhe kësaj kategorie i është ordinuar skringing mamografia pas 1 viti.

BIRADS 3 janë diagnostikuar 1 rast; është ordinuar përcjellje e shkurtër e ndryshimeve (6 muaj)

BIRADS 4, 5 dhe 6 nuk janë evidentuar.

Tabela 4. BIRADS vlerësimi i femrave të ekzaminuara në Komunën e Ranillugut.

BIRADS assesment	N	%
BIRADS 0	19	20.4
BIRADS 1	35	37.6
BIRADS 2	37	39.8
BIRADS 3	2	2.2
BIRADS 4	0	0.0
BIRADS 5	0	0.0
BIRADS 6	0	0.0
Total te vleresuara	93	100.00

Në bazë të ACR vlerësimit të dendësisë së gjinjëve, nga të dhënat e mblledhura kanë rezultuar se 74% (N=54) i takojnë kategorisë me densitet të ulët (ACR 1 dhe 2), favorizon efektshmërinë e mamografisë si metodë skringingu në popullatën e Kosovës.

Kategoritë ACR 3 dhe 4 kanë rezultuar 27% (N =25) dhe për kompletim të ekzaminimit preferohet ekzaminimi me ultrazë.

Tabela 5. ACR vlerësimi dendësisë së gjinjëve

ACR breast density assesment	N	%
ACR A (1)	41	44.1
ACR B (2)	27	29.0
ACR C (3)	18	19.4
ACR D (4)	7	7.5
Total assesed	93	100.0

Lindshmëria e femrave të ekzaminuar sillet rreth 2.9 lindje.
Rreth 80.7% të femrave të ekzaminuara kanë nga 2-3 lindje.

Anamnezë pozitive familjare për kancer të gjirit kanë rezultuar 3.2% (N=3) nga femrat e ekzaminuara.

Tabela 6. Anamnezë familjare për kancer të gjirit.

Positiv familiar anamnesis of BC	N	%
Pozitive	3	3.2
Negative	90	96.8
Total	93	127.4

Mikrodatat mbi gjeneralet e pacientëve, informatat tjera të marra përmes pyetësorit në formë elektronike dhe të shtypura janë pjesë e të dhënave shëndetësorë personale të pacientëve dhe mund të shfrytëzohen nga mjeku i tyre apo me kërkesë të IKSHPK (Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës).

2. Vështirësitë e hasura

2.1. Vështirësitë teknike

- Vështirësitë në komunikim (shpenzimet e telefonisë mobile) vazhdojnë të shkaktojnë vonesa në shkëmbim të informatave, dhënjen e udhëzimeve dhe ofrimin e zgjedhjeve të shpejta ndaj kërkesave të ekipës në terren.

2.2. Vështirësitë kadrovike

- Mungesa e radiologut permanent në ekipë të terrenit që do të monitoroj kualitetin e punës në terren.

2.3. Vështirësitë në mbledhjen e informatave për pacientët me gjetje të dyshimta

- Pacientët me gjetje mamografike që kërkojnë evaluim të mëtutjeshëm janë referuar në Spitalin Regjional të Gjilanit dhe mbledhja e të dhënave për gjetjet përfundimtare te këta pacient vazhdon të jetë e vështirë.

3. Zgjedhjet e sugjeruara

- Sigurimi i formës elektronike të raportimit/ruajtjes së ekzaminimeve mamografike.
- Kompletimi i ekipës së terrenit me së paku një radiolog permanent.
- Sigurimi i formave të komunikimit në mes të stafit (mbulimi i shpenzimeve të telefonisë).
- Ngritja e kapaciteteve teknike dhe kadrovike në Klinikën e Radiologjisë, Departmentin e Imazherisë së Gjirit – si qendër referente për rastet me gjetje të dyshimta ku do të kryhet imazheria komplete dhe definitive diagnostike. Përpilohet dhe dorëzohet në shqyrtim Projekti “Ma-Mo-2” për evaluim definitiv të pacientëve me gjetje BIRADS – 0 në kuadër të QKUK-se.

4. Plani për periudhën e ardhshme

- Nga 30.06.2015 deri më 08.07.2015, me Mamografi mobil planifikohet të ekzaminohen gratë nga Komuna e Partesit dhe më pas në Komunën e Kllokotit dhe me këtë mbulohet e tërë Regjioni i Anamoravës.